



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Doretuar Punilpeno/Prodato Received/ Delivered	22.12.2022	2	viti god year
Organ /Mesa Organ /Jedinstvo Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPMUSHEK	8370/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.985/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Malsore Gashi-Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.985/2022 të datës 09.11.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] të cilin me autorizim e përfaqëson Av. [redacted] me adresë [redacted] kundër Vërejtjes me shkrim Nr.0000794/22 të datës 14.10.2022 të Zëvendësuesit të Drejtorit të Qendrës Korrektuese ne Smrekovnicë, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 22.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.985/2022 e datës 09.11.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

II. Mbetet në fuqi Vërejtja me numër Nr.0000794/22 e datës 14.10.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit, nga Zëvendësuesi i Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë në cilësinë e Udhëheqësit të drejtpërdrejtë, në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] është i punësuar në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas Akt emërimit AE.Nr.070/2022 të datës 26.08.2022 në pozitën "Zëvendës Drejtor", pranë Qendrës Korrektuese ne Smrekovnicë.Me datën 14.10.2022,Zëvendësuesi i Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, i ka shqiptuar ankuesit Vërejtjen me numër Nr.0000794/22, me arsyetimin se i

njëti me datën 13.10.2022 ka munguar pa arsye në punë dhe se i njëti për këtë nuk ka bërë kërkesë paraprake për pushim vjetor.

Ankuesi i pakënaqur me vërejtjen e datës 14.10.2022, e shqiptuar nga ana e Zëvendësuesit të Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë, me datën 09.11.2022, ka parashtruar ankesën me Nr.Prot:6928/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike dhe për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datën 25.11.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Shërbimi Korrektues i Kosovës. Shërbimi Korrektues i Kosovës, me datën 05.12.2022, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 09.11.2022 me Nr.Prot:6928/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e përfaqësuesit ligjor të ankuesit; Vendimin me numër Nr.0000794/22 të datës 14.10.2022 lidhur me shqiptimin e vërejtjes me shkrim ndaj ankuesit; Komunikimet elektronike përmes wiber të datës 09.11.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 25.11.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 05.12.2022 nga Shërbimi Korrektues i Kosovës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Akt emërimit të ankuesit me numër AE.Nr.070/2022 të datës 26.08.2022; Formularin e rezultateve në punë për ankuesin të datës 18.01.2021 për ankuesin; Formularin e rezultateve në punë për ankuesin të datës 17.01.2022 për ankuesin; E-mailat zyrtar të datës 02.12.2022, 20.12.2022, 13.10.2022, 20.12.2022 dhe kontratën e punës për kohë të pacaktuar të ankuesit të datës 15.07.2020.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka vërtetuar se ankesa e ankuesit _____, është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ndërlidhur me përgjegjësinë disiplinore të ankuesit ka analizuar Vërejtjen Nr.0000794/22 të datës 14.10.2022 e shqiptuar ndaj ankuesit dhe ka konstatuar se e njëjta i është shqiptuar nga Zëvendësuesi i Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë si udhëheqës i drejtpërdrejtë i tij, bazuar në nenin 47 paragrafin 1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, për shkak të mungesës në punë pa arsye me datën 13.10.2022, dhe se i njëti nuk ka bërë kërkesë paraprake për pushim vjetor, me ç' rast ka bërë shkelje të lehtë disiplinore, të përcaktuar si në nenin 9, pika 5 e Rregullores (QRK) Nr.07/2022 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë. Ndërlidhur me situatën faktike për mungesën në punë e mbi bazën e të cilës është shqiptuar vërejtja me shkrim ndaj ankuesit, Këshilli bazuar në përgjigjen e siguruar nga organi i punësimit lidhur me ankesën e ankuesit, fillimisht ka analizuar komunikimin zyrtar përmes e-mailit të datës 13.10.2022 ndërmjet ankuesit dhe zyrtarit të personelit pranë këtij institucioni, ku i njëti deklaroi se, citoj: "Sot jam në pushim vjetor, dhe kam qenë në shqyrtim të rasteve komision disiplinor", ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës sipas e-mailit zyrtar të datës 20.12.2022 dhënë për Këshillin, ndërlidhur me rastin e ankuesit e mungesën e tij në punë për datën e cituar më lartë, ka



deklaruar se, citoj: *"Ju informoj se [redacted] nuk ka parashtruar kërkesë për pushim as në formë elektronike e as në formë fizike për datën e lartshënuar"*, prandaj me këtë rast ankuesi ka vepruar në kundërshtim me nenin 4 paragrafin 1 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Orari i punës së nëpunësve civilë, stafit teknik dhe mbështetës si rregull fillon në orën 08:00 dhe përfundon në orën 16:00 pesë (5) ditë në javë duke filluar nga e hëna deri të premtën"*. Ndërlidhur me vërtetimin e gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankuesit, Kolegji ka konstatuar se i njëjti në bazë të dëshmimeve të siguruara nga organi i punësimit, për datën 13.10.2022, fillimisht nuk ka paraqitur fare kërkesë tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i tij lidhur me realizimin e pushimit për këtë ditë, e po ashtu nuk ka paraqitur fare dëshmi tek Zyra e burimeve njerëzore të Shërbimit Korrektues të Kosovës lidhur me mungesën e tij në punë, veprim ky i cili bie ndesh edhe me nenin 9 paragrafin 5 të Rregullores (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, në të cilin përcaktohet se: 5. *"Mos respektimi i orarit të punës, sipas Ligjit përkatës për Zyrtarët Publik paraqet shkelje disiplinore"*.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas vërtetimit të gjendjes faktike lidhur me ankesën e ankuesit, ka konstatuar se Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë në rastin konkret Zëvendësuesi i Drejtorit në Qendrën Korrektuese në Smrekovnicë në kuadër të Shërbimit Korrektues të Kosovës, ka arritur të konstatoj saktë gjendjen faktike dhe juridike në lidhje me shqiptimin e masës disiplinore "Vërejtje" dhe ka vepruar në pajtim me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili thekson se: *"ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit; kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; ndodhja e pasojës; ndodhja e dëmit dhe lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit"*, sepse bazuar në konstatimet e mësipërme janë vërtetuar saktë veprimet e paligjshme të ankuesit me rastin e mungesës në punë për datën 13.10.2022, gjë për të cilën me asnjë fakt nuk ka arrit të dëshmoj apo arsyetoj këtë mungesë tek organi i punësimit për këtë periudhë kohore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbi bazën e asaj që u tha më lartë në arsyetim të këtij vendimi konstaton se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, me rastin e ndërmarrjes së veprimeve ligjore lidhur me shqiptimin e vërejtjes ndaj ankuesit, ka vepruar në pajtim me detyrat dhe përgjegjësitë e nenit 48 paragrafit 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, në të cilin përcaktohet se: *"2. Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil"*, e po ashtu edhe në pajtim me nenin 8 paragrafin 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, në të cilin përcaktohet se: *"2. Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1..."* dhe rrjedhimisht edhe pretendimet e ankuesit në këtë kontekst janë të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.985/2022, datë 22/12/2022.

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional



Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet;

- Përfaqësuesit me autorizim të ankuesit, Av. [REDACTED]
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

